

VENDIM
Nr.789, datë 16.11.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË DELVINË, TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Delvinë, të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë së Delvinës, miratuar me vendimin nr.161, datë 25.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Delvinë të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Delvinës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Delvinë
Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3,5-7,9-12,14-15,20-22	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë (toka produktive)	Në përdorim
4,8,13,16-19,23,52	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë (toka jo produktive kanale të treta)	Në pronësi
24-35,108,109	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
80,84	Prona që përdoren në fushën e funksioneve administrative	Në pronësi
89-94,96-101	Prona që përdoren në fushën e arsimit	Në pronësi
105-107	Prona që përdoren në fushën kulturore e sportive	Në pronësi
110	Prona që përdoren në fushën sociale	Në pronësi
111	Shërbim funeral	Në pronësi
118-172-198	Infrastrukturë dhe shërbime publike	Në pronësi
219-278	Pyje kullota	Në pronësi